



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 924/4 prot.

Tiranë më 23.07.2019

VENDIM

Nr. 21, datë 23.7.2019

PËR KONTROLLUESIN "KOMATAS TOURS"

Në mbështetje të neneve 29, 30, dhe 32, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Komatas Tours",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.186, datë 12.06.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 21.06.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Komatas Tours", me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Komatas Tours", konstaton se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21, dhe nenit 22, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar: "...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22, të këtij ligji, të njoftuar më parë".

Kontrolluesi “Komatas Tours” ushtron aktivitet duke filluar nga viti 2016. Detyrimi për njoftim është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të përmbush Kontrolluesi përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë. Formularit i njoftimit i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi çdo përpunim të të dhënave personale që kryen kontrolluesi dhe mundësinë e ushtrimit të të drejtave që ju jep ligji. Detyrimi për përditësim ekziston sa herë përpunohen kategori, nivele, apo sasi të ndryshme të të dhënave personale.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma “d”, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

2. Kontrolluesi, nuk ka hartuar një Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, por ka një Rregullore të brendshme.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pika 2/1: “Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.

Hartimi dhe përdorimi nga nëpunësi, të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre, është e një rëndësie të veçantë. Për këtë arsye duhet të hartohet një rregullore e detajuar e cila të jetë e zbatueshme në praktikë dhe të reflektojë masa konkrete, sipas standardit të parashikuar.

3. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi, nëpërmjet të cilit mbikëqyr hyrjen dhe ambientin e brendshëm të zyrës. Kontrolluesi nuk informon nëpërmjet tabelave, subjektet e të dhënave “nëpunës”, “vizitor”, etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), sipas standardit të Udhëzimit nr.3/2010, të Komisionerit.

Ky konstatim përbën shkelje administrative të nenit 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.03/2010, “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, të Komisionerit.

Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë, etj.

4. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar “Deklaratat e Konfidencialitetit” me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, sipas standardit të Vendimit nr.06, datë 05.08.2013, të Komisionerit.

Konstatimi përbën shkelje të nenit 28, të ligjit, i cili parashikon se: *"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj"* si dhe Vendimit nr.6/2013 të Komisionerit *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"*.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull *"Deklaratë Konfidencialiteti"*, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"*, merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 21.06.2019, i cili pasi u lexua, u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit u shpreh se: *"Nuk ishim në dijeni të ligjit dhe brenda afateve do marrim masat të plotësojmë konstatimet e mësipërme."*

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*, kontrolluesi *"Komatas Tours"* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, më datë 02.07.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi më datë 26.06.2019, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit masat e marra:

1. Ka bërë njoftimin sipas nenit 21, ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar.
2. Ka hartuar një Rregullore *"Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"*
3. Ka bërë përditësimin e tabelave për njoftimin e klientëve dhe punonjësve në lidhje me pranin e sistemit CCTV, sipas standardit të parashikuar në Udhëzimin nr.3/2010, të Komisionerit.
4. Kontrolluesi ka nënshkruar *"Deklaratat e Konfidencialitetit"* me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, sipas standardit të Vendimit nr.06, datë 05.08.2013, të Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë dëgjimore, ku ka argumentuar se janë marrë masat për të realizuar detyrat e lëna nga hetimi administrativ, të cilat janë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit në një datë të mëhershme.

Kontrolluesi "Komatas Tours", në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë reagimin e menjëhershëm të Kontrolluesit në lidhje me shkeljet e konstatuara si dhe bashkëpunimin e treguar me grupin e kontrollit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 29, 30, 39, pika 1, gërma "d", si dhe nenet 40, dhe 41, të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Komatas Tours" me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Kontrolluesi "Komatas Tours", në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, sa herë përpunohen kategori, nivele, apo sasi të ndryshme të të dhënave personale.
3. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 23.07.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

